



Datë: 18.06.2025
Numër Protokolli: 4134/2025

A.nr.724/2025

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani, kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtare, me Sabile Avdyli, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.724/2025, të datës 24.04.2025, të parashtruar nga ankuesit: B.H; A.B, G.E, F.V, N.B, F.Sh, F.T, L.F-G, B.F, L.B, B.N, Xh.N, H.D, L.P, A.F, A.M, E.S, A.E-M, F.Sh, S.B,A.A-D, I.B, D.Z, A.G-B, N.L-H, I.H , A.H,G.E,B.B,Rr.H, V.B, A.Sh, S.K, Sh.E,Sh.G, F.K, S.T , D.Gj, R.Z, A.H, B.B, A.K, B.P, L.K-P, A.K, K.K, F.R, E.F, F.Z, L.Th, Sh.Xh-K, K.R, Sh.Th, G.Q, Sh.H, L.F-A, F.Ll, L.V-P, M.B, G.H, B.Th, A.Q, G.E, B.B, E.H, A.I-D, R.G, A.C, F.V, A.G, B.M, L.N, M.H, F.H, V.M-Sh, F.N-S, M.D, A.B, K.Q, R.L, K.B, K.R, A.C, M.G, P.B , H.E, A.K-S, E.T, D.N dhe F.M të cilët më autorizim i përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “Klinaku & Associates L.L.C”, nga Prishtina, kundër organit të punësimit: Komuna e Drenasit, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin dhe 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 18.06.2025 mori:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.724/2025, e datës 24.04.2025, e parashtruar nga ankuesit B.H; A.B, G.E, F.V, N.B, F.Sh, F.T, L.F-G, B.F, L.B, B.N, Xh.N, H.D, L.P, A.F, A.M, E.S, A.E-M, F.Sh, S.B,A.A-D, I.B, D.Z, A.G-B, N.L-H, I.H , A.H,G.E,B.B,Rr.H, V.B, A.Sh, S.K, Sh.E,Sh.G, F.K, S.T , D.Gj, R.Z, A.H, B.B, A.K, B.P, L.K-P, A.K, K.K, F.R, E.F, F.Z, L.Th, Sh.Xh-K, K.R, Sh.Th, G.Q, Sh.H, L.F-A, F.Ll, L.V-P, M.B, G.H, B.Th, A.Q, G.E, B.B, E.H, A.I-D, R.G, A.C, F.V, A.G, B.M, L.N, M.H, F.H, V.M-Sh, F.N-S, M.D, A.B, K.Q, R.L, K.B, K.R, A.C, M.G, P.B , H.E, A.K-S, E.T, D.N dhe F.M kështu që **detyrohet** Kryetari i Komunës së Drenasit, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimit, dhe të ndërmarr veprimet që të shqyrtoj kërkesën e datës 18.10.2024 të ankuesve.

II. Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, **shpallet jo kompetent** për të vendosur lidhur me ankesën me numër A.nr.724/2025, të datës 24.04.2025, të parashtruar nga ankuesi Rr.H.

III. Lënda e ankuesit sipas pikën II të dispozitivit të këtij vendimi i delegohet për shqyrtim Komisionit për Ankesa në Komunën e Drenasit.

IV. Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim për veprimet e ndërmarra si në pikën I të dispozitivit.

Ar sy e t i m

Ankuesit përmes postes më datë 18.04.2025, kanë parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e pranuar në Këshill më datë 24.04.2025, dhe e regjistruar nën shenjë A.nr.724/2025, kundër mos përgjigjes nga organi i punësimit lidhur me shqyrtimin e kërkesës të datës 17.03.2025, me pretendimin mbi të drejtën e kompensimit të përvojës së punës nga 0.25% në 0.5%, nga koha kur ha hy në fuqi Ligji i Pagave në Sektorin Publikë dhe në vazhdimësi në 0.5%.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 06.05.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Drenasit, ndërsa, kjo e fundit më datë 12.05.2025, ka dërguar përgjigjen në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritore administroi këto prova:

Ankesën me nr prot.2721/2025 të datës 24.04.2025 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigje në ankesë e datës 07.05.2025; Akt emërimi i L.B i datës 21.01.2024; Akt emërimi I F.R i datës 28.08.2024; Akt emërimi I F.K i datës 06.06.2012; Akt emërimi i A.H i datës 29.06.2018; Akt emërimi i M.D i datës 28.09.2019; Vendim I datës 03.12.2021; Vendim e datës 03.12.2021; Akt emërimi i A.K i datës 27.12.2022; Akt emërimi i K.R i datës 06.06.2012; Akt emërimi i L.TH i datës 07.10.2019; Akt emërimi i G.E i datës 28.02.2022; Akt emërimi i F.H i datës 28.12.2022; Akt emërimi i V.SH i datës 01.03.2022; Akt emërimi i K.Q i datës 28.09.2022; Akt emërimi i F.N i datës 24.06.2021; Akt emërimi i K.B i datës 06.12.2019; Akt emërimi i E.S i datës 18.05.2022; Akt emërimi i F.V i datës 28.02.2022; Akt emërimi i A.F i datës 03.04.2025; Akt emërimi i G.E i datës 07.06.2012; Akt emërimi i B.H i datës 18.05.2022; Akt emërimi i B.B i datës 20.11.2023; Akt emërimi i B.M i datës 06.06.2012; Akt emërimi i M.H i datës 27.04.2017; Akt emërimi i L.N i datës 02.11.2021; Akt emërimi i E.T i datës 13.01.2022; Akt emërimi i E.F i datës 20.11.2023; Akt emërimi i F.N i datës 18.02.2022; Akt emërimi i D.N i datës 29.10.2021; Akt emërimi i H.E i datës 06.06.2012; Akt emërimi i A.D i datës 06.06.2012; Akt emërimi i E.H i datës 06.06.2012; Akt emërimi i A.G i datës 07.06.2012; Akt emërimi i A.Q i datës 29.09.2023; Akt emërimi i B.B i datës 06.06.2012; Akt emërimi i B.P i datës 21.04.2022; Akt emërimi i G.H i datës 06.03.2019; Akt emërimi i L.P i datës 07.06.2012; Akt emërimi i L.F i datës 05.04.2018; Akt emërimi i F.Z i datës 15.03.2022; Akt emërimi i Sh.Th i datës 18.02.2022; Akt emërimi i Sh.H i datës 08.04.2021; Akt emërimi i A.K i datës 27.02.2015; Akt emërimi i K.K i datës 08.06.2012; Akt emërimi i L.Q i datës 20.02.2013 Akt emërimi i A.Sh i datës 06.06.2012; Akt emërimi i V.B i datës 07.06.2012; Kontratë pune e datës 20.10.2023; Akt emërimi i Sh.B i datës 06.06.2012; Akt emërimi i Sh.E i datës 08.06.2012; Akt emërimi i S.K i datës 06.06.2012; Akt emërimi i R.Z i datës 06.06.2012; Akt emërimi i D.Gj i datës 27.02.2012; Akt emërimi i S.T i datës 06.06.2012; Akt emërimi i A.B i datës 19.06.2019; Akt emërimi i F.Sh i datës 28.03.2014; Akt emërimi i N.B i datës 20.09.2022; Akt emërimi i F.T i datës 04.06.2021; Akt emërimi i Xh.N i datës 07.02.2014; Akt emërimi i B.F i datës 14.06.2012; Akt emërimi i L.P i datës 25.02.2019; Akt emërimi i H.D i datës 08.06.2012; Akt emërimi i A.E i datës 23.05.2014; Akt emërimi i A.M i datës 24.09.2019; Akt emërimi i S.B i datës 07.06.2012; Akt emërimi i D.Z i datës 07.06.2012; Akt emërimi i I.B i datës 28.02.2022; Akt emërimi i A.G i datës 20.11.2018; Akt emërimi i N.H i datës 07.06.2012; Akt emërimi i B.N i datës 07.06.2012; Akt emërimi i I.H i datës 08.06.2012; Akt emërimi i M.B i datës 16.03.2022; Akt emërimi i A.C i datës 07.06.2019; Akt emërimi i R.E i datës 08.04.2021; Akt emërimi i L.F i datës 03.12.2013; Akt emërimi i A.S i datës 07.08.2018; Akt emërimi i G.Q i datës 21.04.2022; Akt emërimi i Sh.Xh i datës 06.06.2012; Akt emërimi i M.G i datës 01.06.2012; Akt emërimi i K.R i datës 14.02.2022; Akt emërimi i A.B i datës 04.10.2021; Akt emërimi i F.V i datës 18.08.2021; Akt emërimi i R.G i datës 06.06.2012.

Ankesën me nr prot.2800/2025 të datës 28.04.2025 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimi I datës 10.04.2025; Kopja e letërnjoftimit të ankuesit; Ankesë kundër vendimit nr. 596 të datës 20.03.2025; Përgjigje në ankesë nga organi I punësimit bashkë me shkresat e lëndës; Akt emërimi me nr prot. 123 i datës 28.12.2017 I M.B; Përshkrimi I detyrave të punës; Akt emërimi

me nr prot. 118 I dates 28.12.2021 I N.G; E-mail I dates 23.12.2024; Dëftesa për pranimin e vendimeve të komisionit diciplinor; Procesverbali I komisionit disiplinor I dates 27.01.2025; Procesverbale të datës 08.01.2025; Procesverbalet e datës 31.01.2025; Procesverbalet e datës 05.02.2025; Procesverbal i datës 22.01.2025; Procesverbal I datës 26.12.2024; Procesverbal të datës 22.01.2025; Procesverbal I datës 19 dhe 20.03.2025; Dëftesa me nr prot. 596 e datës 25.05.2025;; Emailat e datës 13.02.2025; Procesverbal e datës 08.01.2025; Email-at të datës 03.01.2025; Dëftesa me nr prot. 597 I datës 20.03.2025; Email-at të datës 13.02.2025; Dëftesë me nr prot. 595 e datës 04.04.2025; Vendim me nr prot. 567, 593, 594, 595, 596, 598 të datës 20.03.2025; Dëftesë me nr prot. 594, 594 e datës 25.03.2025; Procesverbali i datës 28.01.2025; Email I datës 30.01.2025; Email I datës 28.01.2025; Email I datës 06.02.2025; Vendim me nr prot. 181 i datës 06.02.2025; Kontrata publike kornizë me nr prot. 136/23; Formular për dorëzimin e tenderit; Specifikimet teknike të detyrueshme; Deklaratë e 'International Security Association'; Çertifikatë e regjistrimit; Deklaratë e Garantuesit; Dëftesa për pranim-dorëzimin e vendimeve të Komisionit Disiplinor; Procesverbali i Komisionit Disiplinor i datës 27.01.2025; Email I datës 27.01.2025; Vendim i datës 10.01.2024; Email i datës 11.01.2024; Email I datës 20.02.2025; Procesverbali i datës 21.02.2025; Email i datës 03, 20, 27 dhe 24.02.2025; Përcaktimi I objektivave vjetore; Kërkesë me nr prot. 652 i datës 17.11.2023; Email I datës 29.01.2025; Email-at e datës 28.01.2025; Email I datës 22.01.2025; Kërkesë nga zyra e punësimit në Ferizaj e datës 17.11.2023; Ditari I punës; Kërkesë nga zyra për punësim e Ferizajit; Email i datës 27.01.2025; Email-at e datës 06.02.2025; Vendimi me nr prot. 487 i datës 12.07.2024; Raport mbi shërbimin të pastrimit të objektit; Raporti mujor për kryerjen e Shërbimeve të pastrimit dhe mirëmbajtjes; Email-at e datës 20.02.2025; Urdhëra pagese nga Ministria e financave, punës dhe transfereve; Raporte mbi shërbimin e sigurimit të objektit të ZP-Ferizaj; Vendim me nr prot. 1747 i datës 16.02.2024; Raporte mujore për kryerjen e Sigurimit fizik të objekteve; Vendim me nr pro. 1747 të datës 16.09.2024; Vendim me nr prot. 540 I datës 19.08.2024; Vendim me nr prot. 486 I datës 17.06.2024; Vendim me nr prot. 421 I datës 18.06.2024; Vendim me nr prot. 341 I datës 20.05.2024; Vendim me nr prot. 245 I datës 22.04.2024; Vendim me nr prot. 188 I datës 18.03.2024; Vendim me nr prot. 111 I datës 21.02.2024; Vendim me nr prot. 49 I datës 22.01.2024; Vendim me nr prot. 731 I datës 18.12.2023.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur se ankesa e ankuesve si në pikën I të dispozitivit, është e pabazuar, **sepse**:

Nga shqyrtimi i provave të administruara rrjedhë së ankuesit si në pikën I të dispozitivit të këtij vendimit, posedojnë Akte të Emërimit dhe rrjedhimisht të gjithë kanë statusin e nëpunësit të shërbimit civil, dhe janë të punësuar në kuadër të administratës të Komunës së Drenasit.

Ankuesit përmes përfaqësuesit të tyre Shoqëria e Avokatëve "Klinaku & Associates L.L.C", fillimisht më datë 17.03.2025, kanë parashtruar kërkesë tek punëdhënësi për kompensimin e përvojës së punës nga 0.25% në atë 0.5%, dhe atë nga hyrja në fuqi e Ligjit për Pagat në Sektorin Publikë, ndërsa, të njëjtit nuk kanë marrë përgjigje nga Komuna e Drenasit.

Ankuesit në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kërkojnë aprovimin e ankesës së tyre dhe të detyrohet Komuna e Drenasit që të bëjë kompensimin për vlerën sipas përvojës së punës nga 0.25% tani e tutje në 0.5% nga koha kur ka hyrë në fuqi Ligji i Pagave në Sektorin Publikë dhe në vazhdimësi.

Ankuesit kundër heshtjes administrative të organit të punësimit, kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, që të aprovoj ankesën e tyre dhe të obligoj Komunën e Kaçanikut që të njohë këto të drejta gjegjësisht kompensimin e shtesës në pagë prej 0.5% nga data 06.02.2023 e tutje, ashtu siç kanë realizuar para hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë,

Kolegji i Këshillit, ndërlidhur me rregullat e veprimeve procedurale të një organi publik, ju referua dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (*tutje referuar: LPPA*), përkatësisht nenit 10 paragrafi 2 ku përcaktohet se: 2. *Organi publik zhvillon procedurën administrative sa me të shpejtë dhe me sa më pak shpenzime, për të dhe për palën, duke mos cenuar çfarë është e nevojshme për një rezultat të ligjshëm*

e të përshtatshëm të procedurës administrative, nenit 98 paragrafi 1 dhe 2 ku përcaktohet se: 1. *Procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure.* 2. *Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj, si dhe nenit 97 paragrafi 1 të këtij ligji, ku përcaktohet se: 1. Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon me njoftimin e një akti administrativ apo lidhjen e një kontrate administrative, dhe si rrjedhojë në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe bazuar në shqyrtimin e provave materiale të çështjes, Kolegji i Këshillit konstatoi se organi përkatës i punësimit, në rrethanat e rastit konkret, nuk ka vepruar në pajtueshmëri me dispozitat përkatëse ligjore, në raport me Kërkesën e datës 17.03.2025 të parashtruar nga ankuesit, ngase sipas bazës ligjore si me sipër, vullneti i organit publik në realizimin e autoritetit publik formësohet në procedurë administrative dhe manifestohet në formën e njërit prej veprimeve administrative, siç janë: akti administrativ; kontrata administrative apo akti real, dhe se në vlerësimin e Kolegjit, organi përkatës i punësimit, në kuadër të autorizimeve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi, është dashur që të shqyrtoj kërkesën e ankuesve të datës 17.03.2024 dhe të nxjerrë akt administrativ në kuptim të vendosjes dhe të njoftoj palën për aktin e tillë, brenda një afati prej 45 ditësh sikurse përcaktohet me nenin 98 paragrafi 2 apo afatit të vazhduar sipas nenit 99 paragrafi 1 të LPPA-së.*

Rrjedhimisht, në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit, heshtja dhe mos përgjigja e organit të administratës në raport me kërkesën e ankuesve të datës 17.03.2025, cenojnë të drejtat e ankuesit në kuptimin e të drejtave procedurale dhe për rrjedhojë edhe vendosjen në mënyrë meritore, ngase, ashtu sikurse është thënë në arsyetim të këtij vendimi, në kërkesën e parashtruar të organi i punësimit, ankuesi pretendon realizimin e një drejte ligjore.

Kështu që thënë si më sipër e duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi të aprovoj si të bazuar ankesën e ankuesit vetëm në kuptim të shkeljeve procedurale, duke detyruar Kryetarin e Komunës së Drenasit, që të shqyrtoj kërkesën e ankuesve të datës 17.03.2024, në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë dhe të nxjerr akt administrativ lidhur me kërkesën e shqyrtuar.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovë **nuk është kompetent** për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesi si në pikën II të dispozitivit, **sepse:**

Nga provat e lëndës, Kolegji i Këshillit, ka gjetur se ankuesi Rr.H sipas Kontratës së punës me Nr.112/08-52305 të datës 20.10.2023 është i punësuar në pozitën pastrues në objektin e ri të Komunës së Drenasit.

Kolegji i Këshillit, lidhur me statusin e pozitës së ankuesve të cekur si më lartë, ju referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht neni 5 paragrafi 3 dhe 5 përcakton se: 3. *Nëpunësja/i i shërbimit publik është zyrtarja/i publik i cili ofron shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit, në fushën e mjekësisë ligjore, si dhe shërbime tjera të ngjashme publike. Nëpunësja/i i shërbimit publik ushtron detyrën në pozitën përkatëse duke filluar nga niveli profesional deri në nivelin e lartë drejtues. Nëpunësja/i i shërbimit publik është edhe nëpunësja/i i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike pjesë e administratës shtetërore, në administratën e shërbimeve publike apo pjesë e komunës. 5. Nëpunësja/i teknik dhe mbështetës është zyrtarja/i publik që kryen veprimtari ndihmëse të mirëmbajtjes, të ruajtjes, të vozitjes dhe veprimtari të ngjashme në institucionet publike, po ashtu lidhur me nëpunësit e shërbimit publik dhe nëpunësit teknik dhe mbështetës, Kolegji ju referua nenit 77 paragrafi 1 dhe nenit 95 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, i cili parasheh: “nenit 77. 1. Përveç kur parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë pjesë të ligjit, marrëdhënia e punës për nëpunësen/in e shërbimit*

publik rregullohet sipas dispozitave të Ligjit përkatës të Punës, nenit 95 paragrafi 1 dhe 2, Punëdhënës në marrëdhënien e punës të nëpunëses/it teknik dhe mbështetës është institucioni përkatës, përmes udhëheqëses/it më të lartë administrativ të institucionit. Përveç sa parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë pjesë të ligjit, marrëdhënia e punës ndërmjet institucionit dhe nëpunëses/it teknik dhe mbështetës rregullohet me legjislacionin e punës.

Andaj Kolegji i Këshillit, referuar dispozitave të cekura ma lartë, konstaton se përveç pozitën, pozitat e lartëcekura që mbajnë ankuesit hyjnë në kuadër të nëpunësit teknik dhe mbështetës, e për rrjedhojë duke marr parasysh që këta ankuesit nuk mbajnë pozitë të nëpunësit të shërbimit civil, atëherë duke u bazuar në dispozitat e nenit 6 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent që të shqyrtoj dhe të merr vendime vetëm për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civil të Kosovës, kështu që mbi bazë të këtyre pikëpamjeve Kolegji i Këshillit, vendosi që të shpallë veten jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.32/2025 të datës 08.01.2025 të parashtruar nga ankuesit, kështu që lënda e ankuesve për shqyrtim delegohet tek organi kompetentë respektivisht Komisioni i Ankesave i Komunës së Kaçanikut.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.724/2025

Sabile Avdyli

Procesmbajtës

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të ankuesve Shoqëria e Avokatëve “Klinaku & Associates L.L.C”;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komuna e Drenasit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.